



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0906

OSHP: 2024/0940

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga zv.Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim- paneliste individuale duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik OE N T.SH. “GIPA” si dhe OE “Shaip Mustafa” B.I., kundër vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “FURNIZIMI ME MATERIAL HIGJENIKO – SANITAR PËR SHKOLLAT E KOMUNËS SË RAHOVECIT” me numër të prokurimit 623-24-8150-1-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KUVENDI KOMUNAL – RAHOVECË”, më 12/12/2024, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohen si pjesërisht të bazuara, ankesat e N.T.SH. GIPA me nr. 2024/0906, e datës 25.09.2024 si dhe OE “Shaip Mustafa” B.I., me nr. 2024/0940, e datës 03/10/2024, ndërsa vendimi i AK “KUVENDI KOMUNAL – RAHOVECË” lidhur me aktivitetin e prokurimit “FURNIZIMI ME MATERIAL HIGJENIKO – SANITAR PËR SHKOLLAT E KOMUNËS SË RAHOVECIT” me numër të prokurimit 623-24-8150-1-2-1.

2. Anulohet në tërësi aktiviteti i prokurimit “FURNIZIMI ME MATERIAL HIGJENIKO – SANITAR PËR SHKOLLAT E KOMUNËS SË RAHOVECIT”, me numër të prokurimit 623-24-8150-1-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL – RAHOVECË, dhe nëse AK edhe më tutje ka interes për zhvillimin e këtij aktiviteti të prokurimit, lëndën ta ritenderoj në pajtim me dispozitat e LPP.

3. Lejohet të bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 07.08.2024, “KUVENDI KOMUNAL – RAHOVECË” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “FURNIZIMI ME MATERIAL HIGJENIKO – SANITAR PËR SHKOLLAT E KOMUNËS SË RAHOVECIT” me numër të prokurimit 623-24-8150-1-2-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës për furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 64,704.75 €.

Me 19.09.2024 AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 për shpërblim me kontratë.

Me 21.09.2024 OE N.T.SH. GIPA., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim. Më 24.09.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 23.09.2024, OE “Shaip Mustafa” B.I., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues.

Me 25.09.2024, Autoriteti Kontraktues ka publikuar vendimin përmes të cilit refuzohen si të pa bazuara ankesat e Operatorit ekonomik dhe vërtetohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues .

Me 25.09.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE N.T.SH. GIPA., me numër protokolli 2024/0906 lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizimi me Material Higjieniko – Sanitar për Shkollat e Komunës së Rahovecit me numër të prokurimit 623-24-8150-1-2-1.

Me 03.10.2024, OE “Shaip Mustafa” B.I., ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 0940/2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit “FURNIZIMI ME MATERIAL HIGJENIKO – SANITAR PËR SHKOLLAT E KOMUNËS SË RAHOVECIT” me numër të prokurimit; 623-24-8150-1-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e

ankesave në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 0906/24 dhe ankesa nr. 0940/24 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues N.T.SH. GIPA., janë parashtruar si në vijim:

Operatori Ekonomik NTSH GIPA

Jemi OE i cili plotëson çdo kriter të kërkuar në FDT dhe jemi i vetmi ofertues i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit. Jemi ofertuesi me çmimin më të favorshëm si kriter kryesor, i cili ruan dhe mbron buxhetin e shtetit.

Operatori Ekonomik NTSH GIPA, pas vendimit për dhënien e kontratës dhe pas eliminimit të kompanisë sonë nga gara më datë 19.09.2024, po në këtë datë kemi bërë kërkesë për qasje në dokumentet zyrtare.

Më datë 20.09.2024 është lejuar qasja në dokumentet zyrtare të kompanisë që autoriteti kontraktues ka menduar ta shpërblejë me kontratë, si dhe në raportin e vlerësimit të tenderëve. Më datë 21.09.2024 kemi bërë kërkesë për rishqyrtim, siç pason më poshtë.

Gjatë kontrollit të dokumenteve që na është lejuar të qasemi, përkatësisht në raportin e vlerësimit të tenderëve, kemi vërejtur shumë shkelje që janë bërë në dëm të kompanisë sonë, siç vijon sipas letrës standarde:

1. Arsyeja e eliminimit (sipas AK): Mungesa e identifikimit të kodit të mostrave në formularin e tenderit elektronik.

1.1 Përgjigjja (OE): Në formularin elektronik shihet qartë kodi i ofertës, i cili është i bashkëngjitur me të gjitha mostrave të dorëzuara në zyrën e prokurimit më datën 28.08.2024. Mungesa e identifikimit të mostrave në formularin e tenderit elektronik në hapësirën përkatëse nuk është një kusht administrativ për eliminimin tonë nga gara, as për shpërblimin e operatorit me çmim 53% më të lartë se oferta jonë. Ky fakt nuk e vështirëson punën për identifikimin e mostrave tona, pasi që i njëjti kod gjendet edhe në FDT, i cili është i njëjtë me kodin e tenderit.

Po ashtu, në momentin e dorëzimit të mostrave në zyrën e prokurimit, kemi plotësuar formularin e dorëzimit të mostrave, ku shihet qartë ora, data, përbërja, si dhe kodi i ofertës, i cili gjendet në çdo paketim të mostrave të dorëzuara dhe është i njëjtë me kodin e tenderit të dorëzuar.

2. Arsyeja e eliminimit (sipas AK): Mosdorëzimi i mostrave sipas specifikimeve teknike.

2.1 Përgjigjja (OE): Të gjitha mostrat e dorëzuara në AK plotësojnë kërkesat minimale të specifikimeve teknike të bashkëngjitura në dosjen e tenderit. Shihet qartë ndikimi i Operatorit

Ekonomik fitues ndaj Autoritetit Kontraktues për marrjen e një vendimi të padrejtë. Disa produkte të cekura në refuzimin e kërkesës për rishqyrtim janë si më poshtë:

A) Paramasa Nr. 6 – Është kërkuar kovë plastike për ujë 25L.

AK bie në kundërshtim me arsyen e refuzimit, ku sipas përgjigjes thotë se keni sjellë kova 20L të paspecifikuar për litrazhin. Si është e mundur që AK të ketë informacion se sa litra bart kova, kur në të njëjtën përgjigje thuhet se nuk është specifikuar? Shihet qartë nga stampimi që kova ka kapacitet 25L, dhe këtë mund ta shihni edhe në foto.

B) Paramasa Nr. 12 – Qese për mbeturina 1x10 150L.

AK thotë se nuk është specifikuar sasia dhe litrazhi. AK bie në kundërshtim edhe në këtë produkt, pasi shihet qartë litra e shënuar, emri i prodhuesit, si dhe sasia e produktit, të cilën mund ta hapni dhe ta numëroni lehtësisht. Po ashtu, ne si Operator Ekonomik e kemi specifikuar edhe në katalog të njëjtin produkt, i cili përmban 1x10 copa 150L.

C) Paramasa Nr. 18 – Është kërkuar dezinfektues-gel për duar 500 ml.

AK thotë se kemi sjellë dezinfektues në formë lëngët. Në produktin e ofruar nga prodhuesi "Fresh Co", në etiketë shihet përshkrimi i përmbajtjes së produktit (ALCOHOL GEL) 500 ml. Ne si Operator Ekonomik nuk kemi ndonjë laborator për verifikimin e specifikimeve dhe bazoheni vetëm në përshkrimin e prodhuesit.

D) Paramasa Nr. 34 – Është kërkuar dezinfektues për tavolina, karrige, tastatura.

Në produktin tonë të dorëzuar nga prodhuesi "Fresh Co", në etiketën e tij shihet që produkti është dezinfektues për pajisje sanitare, pajisje pune dhe pajisje elektronike, etj. Ai përmban aromë, ngjyrë, dezinfektues dhe përbërës të tjerë, të cilët, sipas hulumtimeve tona, bëjnë pjesë në grupin e surfaktantëve jo jonikë.

3. Arsyeja e eliminimit (sipas AK): Mos përputhja e katalogut me specifikimet teknike.

3.1 Përgjigjja (OE): Katalogu i dorëzuar është në përputhje minimale me specifikimet teknike.

4. Arsyeja e eliminimit (sipas AK): Sipas specifikimeve dhe kërkesave të dokumentacionit të tenderit, operatorët ekonomikë janë të obliguar të dorëzojnë deklaratën për produkte ekologjike si dëshmi.

4.1 Përgjigjja (OE): Shihet qartë se komisioni për shqyrtimin e dokumenteve nuk ka vërejtur se ne në dokumentin me titullin "5. Deklarata mbi specifikat ekologjike dhe afati i dorëzimit.pdf", në përmbajtjen e këtij dokumenti janë përfshirë dy pika (C) mbi deklaratën ekologjike.

Kërkoj nga OShP-ja që të shqyrtojë ankesën tonë dhe ta pranojë si të bazuar, duke shpallur kompaninë tonë si fituese të këtij aktiviteti të prokurimit. Oferta jonë ruan buxhetin e komunës, pasi oferta e OE fitues është 53% më e lartë se oferta jonë.

Kërkoj nga OShP-ja që të ndryshojë vendimin për dhënien e kontratës dhe të shpërblejë me kontratë Operatorin Ekonomik NTSH GIPA

Përgjigje e AK në kërkesën për rishqyrtim:

Bazuar në Rregullore Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, Neni 32 - Dorëzimi i tenderit në formë elektronike:

32.5 Tenderët mund të shoqërohen me dokumente në formë fizike, si: mostrat, katalogët dhe çfarëdo dëshmie tjetër e cila nuk mund të ngarkohet përmes sistemit elektronik të prokurimit. Mirëpo, gjatë hartimit të ofertës elektronike, operatorët ekonomikë duhet t'i specifikojnë dokumentet të cilat do të dërgohen në formë fizike.

1.Mungesa e identifikimit të kodit të mostrave në formularin e tenderit elektronik:

Në hapësirën përkatëse në formularin e tenderit, ku kërkohet që operatori ekonomik të identifikojë dokumentin që dorëzohet ndaras me kodin e mostrave, ju nuk keni ofruar informacionin e kërkuar, duke e lënë atë të paplotësuar. Kjo përbën një shkelje të kërkesave të qarta të dokumentacionit të tenderit.

2.Pretendimi juaj që në formularin elektronik shihet qartë kodi i ofertës, i cili është i bashkëngjitur të gjitha mostrave të dorëzuara në zyrën e prokurimit me datën 28.08.2024, nuk është i saktë pjesërisht:

Edhe pse kodi është i pranishëm në formular dhe i bashkëngjitur mostrave, formulari i tenderit nuk është plotësuar në përputhje me kërkesat specifike të dosjes së tenderit.

Arsyeja e refuzimit: Kërkesa juaj refuzohet si e pabazuar, pasi nuk keni përmbushur kushtet e tenderit. Saktësisht, nuk e keni plotësuar hapësirën e formularit ku kërkohet të identifikohen pjesët e tenderit që do të dorëzohen ndaras. Kjo fushë është kritike dhe e detyrueshme, dhe mos përmbushja e saj përbën shkelje të kushteve të tenderit. Më tej, edhe në hapësirën e formularit të tenderit elektronik, ku kërkohet të shkruhet kodi i tenderit, është plotësuar një kod i njëjtë me atë të bashkëngjitur mostrave. Kjo përbën një problem më vete pasi që keni ngatërruar hapësirat e plotësimit të formularit të tenderit, duke çuar në eliminimin tuaj, pasi formulari i tenderit nuk është plotësuar siç duhet në pjesën përkatëse të kërkuar.

3.Mosdorëzimi i mostrave sipas specifikimeve teknike:

Sipas specifikimeve teknike të përfshira në dokumentacionin e tenderit, operatori ekonomik ka pasur detyrimin të dorëzojë mostra të produkteve për të cilat ka ofertuar. Mostrat e dorëzuara nga ana juaj nuk kanë qenë në përputhje me kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentacion, duke mos përmbushur standardet e kërkuara.

Sipas dispozitave të Ligjit të Prokurimit Publik dhe Rregullores për Prokurimin Publik, operatorët ekonomikë janë të detyruar të dorëzojnë mostra në përputhje me specifikimet teknike

të përcaktuara nga autoriteti kontraktues. Mostrat e dorëzuara nga ana juaj nuk përputhen me specifikimet e kërkuara në dosjen e tenderit, duke qenë jashtë standardeve të kërkuara.

a) Paramasa nr. 6: Kërkohej Kovë plastike për ujë 25 L, ju keni sjellur kovë 20 L të pa specifikuar litrazhin dhe e njëjta nuk i plotëson kushtet sanitare për bartjen e ujit.

b) Paramasa nr. 12: Qese për mbeturina 1x10 150 L, nuk është e specifikuar nga prodhuesi se çfarë sasive përmban dhe çfarë litrazhi ka.

c) Paramasa nr. 18: Kërkohej Dezinfektues – gel për duar 500 ml, ju keni sjellur dezinfektues në formë të lëngët.

d) Paramasa nr. 34: Kërkohej Dezinfektues për tavolinat, karriget, tastaturat, etj., i cili duhet të përmbajë aromë të mirë dhe 5% surfakante jo jonike, aromë limoni, dezinfektues, alkale, citrate dhe ngjyrë. Produkti që ju keni ofruar me emrin tregtar Asepsol Disinfectant ka përbërje aktive: Aqua, quaternary ammonium compounds, benzalkonium chloride, isopropyl alcohol, disodium EDTA, pra mostra nuk është në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktues.

4. Mospërputhje e katalogut me specifikimet e tenderit:

Katalogu i produkteve që keni dorëzuar është analizuar nga komisioni vlerësues dhe është konstatuar se nuk përmban produkte që janë në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentacionin e tenderit.

5. Deklarata për produkte ekologjike:

Sipas specifikimeve dhe kërkesave të dokumentacionit të tenderit, operatorët ekonomikë janë të obliguar të dorëzojnë deklaratën për produkte ekologjike si dëshmi për përmbushjen e standardeve të përcaktuara për këtë aspekt. Ju, si OE, nuk e keni përfshirë këtë deklaratë në dokumentacionin tuaj të ofertës, ashtu si është kërkuar ndarazi, deklarata duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur. Prandaj, oferta juaj nuk është në përputhje me kërkesat teknike të përcaktuara në këtë tender. Bazuar në këtë mos përmbushje, komisioni vlerësues është detyruar të eliminojë ofertën tuaj nga faza e mëtejshme e vlerësimit, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe rregulloret përkatëse.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Shaip Mustafa” B.I., janë parashtruar si në vijim:

Pergjigjje ndaj pretendimeve te AK-se:

Pergjigjje ndaj Pretendimit 1: Siq shihet Tek kerkesat mbi mundesite teknike dhe/ose profesionale kerkesa ka qene e thjesht qe mostrat te kene nje kod te identifikimit gje te cilen ne e kemi bere kemi vendosur kodin tone identifikues SH62 ku ne do ju bashkangjesim foton me te cilen deshmojme qe mostrat tona kane qene me kod sipas kerkeses se AK-se duke eliminuar te gjitha shenjat te cilat mund te identifikohemi si OE, andaj ne kemi plotesuar kerkesen sipas AK-se

Ketu shihet qarte shenja jone identifikuese por qe AK ka vendosur te na eliminoj padrejtesisht.

Pergjigje ndaj pretendimit 2 ; Te gjitha mostrat tona kane qene ne perputhje te plote me kerkesat e AK-se dhe sipas katalogut te cilin e kemi prezentuar se bashku me DT. Andaj AK ne piken eliminuese ka thene qe Mostrat e dorezuara nga ana jone nuk jane ne perputhje me kerkesat teknike te percaktuara ne dokumentacion duke mos permbushur standardet e kerkuara. Ligji i LPP-se Neni 54 e parasheh qe AK duhet qe qdo pike eliminuese ta bej te qarte.

AK fare nuk ka bere te qarte pikat eliminuese por vetem ka bere nje permbledhje qe kinse Mostrat tona nuk jane ne perputhje me kerkesat e DT gje e cila eshte ne kundërshtim me ligjin e LPP-se.

Pergjigje ne Pretendimin 3 ; Edhe ketu nuk eshte respektuar Neni 54 ku fare nuk ka cekur pikat eliminuese ose produktin i cili sipas AK nuk ploteson kushtet e DT por vetem ka bere pershkrim te pergjithshem dhe te pasakte pasi qe katalogu jone eshte ne perputhje me mostrat dhe kushtet e AK.

Pergjigje ne Pretendimin 4 : Edhe ketu AK nuk ka bere vleresim korrekt dhe jo te duhur pasi qe formulen qe AK ka vendosur ne paramase ne si OE nuk mund ta ndryshojme dhe ne kemi vendosur cmimin per njesi me cmime reale te tregut.

Ketu shihet qarte qe ne kemi vendosur cmimin per njesi per keto pozicione cmimin real te produktit por qe ne paramasen e vendosur me cmim te peshuar per njesi del cmimi 0.00 dhe AK ka vendosur te na eliminoj me arsyetim qe kemi vendosur cmim ne paramase 0.00 gje e cila nuk eshte e sakte pasi qe nese ne kishim vendosur cmim 0.00 totali i ofertes do te ndryshonte nuk do te kalkulonte pozicionet me cmim 0.00 por qe formula qe ka vendosur AK ka bere llogaritjen e te gjitha pozicioneve te cilat kemi vendosur cmimet ne paramase.

Me daten 19.09.2024 kemi bere kerkese per qasje ne dokumentet dhe mostrat e OE te propozuar per kontrate ku na eshte mundesuar qasja me daten 23.09.2024 ku kemi verejtur mosperputhje ne dokumentacion dhe mostrat e dorezuara nga OE.

Ketu shihet qarte qe OE i propozuar per kontrate ka dorezuar moster Gjoker Gome per pastrimin e dritareve 40cm dhe nuk ploteson kerkesat e DT.

Ketu shihet qarte qe OE ka dorezuar moster me kapacitet 18L dhe nuk ploteson kerkesat minimale te percaktuara ne DT.

Ketu OE i propozuar per kontrate ne moster ka ofruar produktin DOMEKS ndersa ne katalogun e prezantuar ne DT ka ofruar DOMESTOS shih te bashkangjitur:

Ketu verehet qarte qe ka mosperputhje ne mes katalogut dhe mostres se dorezuar andaj AK nuk ka vepruar sipas ligjit te LPP-se dhe ka shperblyer me kontrate nje OE te papergjegjshem.

Edhe ketu si me larte OE i propozuar per kontrate ka mosperputhje mostra me katalogun e dorezuar shih te bashkangjitur:

Ne katalog shihet qarte qe produkti i ofruar nuk eshte i njejti si ne mostren e dorezuar por qe AK nuk ka bere vleresimin e duhur.

Edhe ketu ka mosperputhje te mostres me katalogun e ofruar nga OE Ketu verehet qarte mosperputhja ne mes te katalogut dhe mostres se dorezuar nga OE ku prodhuesi i produktit dallon qarte.

Keto ishin disa nga artikujt qe kane mosperputhje ne mes te katalogut dhe mostres se dorezuar nga OE i propozuar per kontrate por qe AK ka vendosur ta shperblej me kontrate nje OE me te shtrenjte dhe te papergjegjshem duke mos respektuar Nenin 7 te LPP-se. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo në këtë rast AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Me daten 25.09.2024 kemi pranar refuzimin e kërkeses per Rishqyrtim ku edhe njehere AK favorizion nje OE me te shtrenjet dhe jo te pergjegjshem duke pasur parasysh qe ka pasur nje sere shkeljesh ne kete aktivitet te prokurimit.

Tek pretendimi 1 qe kemi bere AK perseri na eleminon me nje arsyetim qe nuk kemi shkruar kodin e mostrave ku ne ju kemi bashkangjitur deshmit me foto poashtu edhe ne fletepranimin e mostrave gjate dorezimit siq kerkohet cdo Autoritet Kontraktues ku behet dorezimi i mostrave dhe pranimi i tyre edhe ne kemi shkruar kodin qe na identifikon neve si kompani prandaj ky pretendim sipas AK duhet te jete i bazuar siq deshmon edhe Neni 37 i RREGULLORES Nr. 001/2022 PËR PROKURIM PUBLIK

Edhe tek pretendimi 2 AK qarte deshmon qe ka vepruar njeanshem duke favoriozuar OE te caktuar dhe duke na eliminuar padrejtesisht pasi qe AK fare nuk ka vepruar sipas Ligjit te LPP-se Neni 54

AK fare nuk ka bere te qarte pikat eliminuese por vetem ka bere nje permbledhje qe kinse Mostrat tona nuk jane ne perputhje me kerkesat e DT gje e cila eshte ne kundarshtim me ligjin e LPP-se.

Përfundim: Në bazë të mospërputhjeve të konstatuara më sipër dhe duke respektuar në plotëni dispozitat e nenit 54 të Ligjit për Prokurimin Publik, dhe në bazë të këtyre argumenteve, pretendimi juaj nr. 3 konsiderohet i pabazuar.

Tek Pretendimi 3 artikulli Qese per mbeturina 30L shihet qarte qe ne kemi ofruar qese 35L ku sipas LPP-se lejohet te ofrohet ekuivalente ose me e avancuar ku ne e kemi ofruar ne kete rast me te avancuar 35L ku cilesohet standard per shporatat per mbeturina. Lecka per pastrimin e dritareve 1/1 ne kemi ofruar lecka 10+2 sipas kerkeses dhe ky produkt i permbush te gjitha kriteret por qe AK ne kerkesen per rishqyrtim vetem bene nje pershkrim qe nuk ka qene sipas kerkeses dhe nuk perputhet me specifikimet teknike ne paramase dhe nuk tregon pikat te cilat nuk i ploteson produkti yne i ofruar. Dezinfektues per tavolin,tastaturakarrige etj ketu shihet qarte ne foto ose ne katalogun e ofruar qe produkti eshte produkt i sakte siq eshte kerkuar pasi qe ky produkt permbush specifkimet teknike siq shihet ne katalogun e ofruar produkti eshe dezinfektues per tavolina,tastatura,karrige etj dhe permbush kriteret 100%.

Tek Pretendimi 4 ju kemi sqaruar me deshmi siq shihet ne foto: Ketu shihet qarte qe ne kemi ofruar cmim real te tregut per njesi e marrim shembull ARTIKULLI NR.5 Politur per mobilje cmimin per njesi me TVSH ne kemi ofruar 0.95cent por qe formula qe ka vendosur AK per kete produkt eshte 0.5% dhe kjo ka bere qe cmimi per njesi i peshuar te duket 0.00 por qe ne totalin e ofertes tone eshte kalkuluar totali i ofertes dhe nuk ka vend ose qellim per manipulim ky detaj mund te verifikohet shume lehte duke verifikuar totalin e ofertes tone dhe ky qendrim i AK nuk qendron.

Gjithashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Lusim organet kompetente te OSHP-së qe te analizojne,vertetojne pretendimet tona ankimore pasi qe ne besojme qe te gjitha keto pretendime ishin pretendime te bazuara ne fakte dhe argumente si rrjedhoje eshte dashur te shpallemi si OE me cmimin me te ulet duke respektuar te gjitha kriteret e DT.

Prandaj, si rrjedhoje te argumenteve te potencuara duhet te ri-konstatojme se Komisionit per vleresimit te Ofertave ka bere shkelje ligjore te Nenit 59 te LPP-se duke bere vleresim subjektiv, jo ligjor, jo profesionale dhe favorizues ndaj O.E te shpallur fitues.

Duke u bazuar në te gjitha dëshmitë dhe faktet qe u ceken më lartë konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 te LPP-së, sepse është rekomanduar për kontratë OE i cili nuk i ka plotësuar te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontratë.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi ekonomikisht më i favorshëm siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.2 i LPP-se sepse është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik i papërgjegjshëm.

Po ashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse është favorizuar operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë duke u rekomanduar për kontratë edhe pse nuk i ka plotësuar të gjitha

kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, ndërsa neve jemi diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTDsë dhe të njoftimit për kontratë.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo në këtë rast AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Gjithashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, OE “Shaip Mustafa” B.I., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 10, 59, 60, 61, 69, dhe 72 të LPP, Neni 41 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik. Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga AK që të nxjerr: VENDIM të APROVOHET ankesa e OE NTP PASHTRIKU si e bazuar, ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-se(formulari B58), si dhe lënda kthehet në RIVLERËSIM, DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së. Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

Përgjigje e AK në kërkesën për rishqyrtim për OE “Shaip Mustafa” B.I.,

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS Lidhur me kërkesën për rishqyrtim nr. 1 ku thuhet: Siç shihet Tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale kërkesa ka qene e thjesht qe mostrat te kenë një kod te identifikimit gjë te cilën ne e kemi bere kemi vendosur kodin tone identifikues SH62 ku ne do ju bashkëngjisim foton me te cilën dëshmojmë qe mostrat tona kane qene me kod sipas kërkesës se AK-se duke eliminuar te gjitha shenjat te cilat mund te identifikohemi si OE, andaj ne kemi plotësuar kërkesën sipas AK-se. Sqarojmë se: Bazuar në Rregullore Nr. 001/2022 për prokurim publik, Neni 32 Dorëzimi i tenderit në forme elektronike, paragrafi 32.5 thuhet se: Tenderët mund të shoqërohen me dokumente në formë fizike, si: mostrat, katalogët dhe çfarëdo dëshmie tjetër e cila nuk mund të ngarkohet përmes sistemit elektronik të prokurimit, mirëpo gjatë hartimit të ofertës elektronike operatorët ekonomik duhet t'i specifikojnë dokumentet të cilat dërgohen në formë fizike 1. Juve si OE nuk e keni identifikuar kodin e mostrave në formularin e tenderit elektronik: Në hapësirën përkatëse në formularin e tenderit ku kërkohet që operatori ekonomik të identifikojë dokumentin që dorëzohet ndaras me kodin e mostrave, ju nuk keni ofruar informacionin e kërkuar, duke e lënë atë të plotësuar me fjalën “jo”. Kjo përbën një shkelje të kërkesave të qarta të dokumentacionit të tenderit. Në bazë të këtyre argumenteve, pretendimi juaj nr. 1 konsiderohet i pabazua

Lidhur me pretendimin nr. 2: Ju njoftojmë se procedura e ndjekur nga Autoriteti Kontraktues ka respektuar në plotëni dispozitat e nenit 54 të LPP-së, duke përfshirë komunikimin e arsyetimit të eliminimit tuaj dhe specifikimet teknike përkatëse që kanë qenë të dokumentuara qartësisht në dosjen e tenderit. Për më tepër, ju është dërguar njoftim me shkrim, siç kërkohet nga ligji, ku janë përfshirë arsyet e refuzimit të ofertës suaj. Arsyetim: Mosdorëzimi i mostrave sipas specifikimeve teknike: Sipas specifikimeve teknike të përfshira në dokumentacionin e tenderit, operatori ekonomik ka pasur detyrimin të dorëzojë mostra të produkteve për të cilat ka ofertuar. Mostrat e dorëzuara nga ana juaj nuk kanë qenë në përputhje me kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentacion, duke mos përmbushur standardet e kërkuara. Sipas dispozitave të Ligjit të Prokurimit Publik dhe Rregullores për Prokurimin Publik, operatorët ekonomikë janë të detyruar të dorëzojnë mostra në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktues. Mostrat e dorëzuara nga ana juaj nuk përputhen me specifikime të kërkuara në dosjen e tenderit, duke qenë jashtë standardeve të kërkuara. Mosplotësimi i Kërkesave Teknike: Nga shqyrtimi i detajuar i dokumentacionit të dorëzuar nga ana juaj, është konstatuar se mostrat nuk kanë përmbushur standardet teknike të kërkuara, siç përcaktohet në katalogun e paraqitur bashkë me dokumentacionin e tenderit. Autoriteti Kontraktues ka për obligim të eliminojë çdo ofertë që nuk i përmbush këto kërkesa, për të garantuar barazinë dhe transparencën në procesin e prokurimit. Në bazë të këtyre argumenteve, pretendimi juaj nr. 2 konsiderohet i pabazuar. Lidhur me pretendimin nr. 3: Mospërputhje e katalogut me specifikimet e tenderit: Katalogu i produkteve që keni dorëzuar është analizuar nga komisioni vlerësues dhe është konstatuar se nuk përmban produkte që janë në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentacionin e tenderit. Në vijim të shqyrtimit të pretendimit tuaj lidhur me mospërputhjen e katalogut tuaj me specifikimet e kërkuara në dokumentacionin e tenderit, ju informojmë se Komisioni Vlerësues ka bërë një analizë të detajuar të produkteve të ofruara nga ana juaj. Nga ky shqyrtim, janë konstatuar disa mospërputhje të qarta ndërmjet ofertës tuaj dhe kërkesave teknike të përcaktuara në dokumentacionin e tenderit, të cilat përshkruhen më poshtë

1. Paramasa Nr. rendor 13 - Qese për mbeturina 1x10 30 L: Sipas kërkesës së përcaktuar në paramasë, për pozicionin 13 është kërkuar "Qese për mbeturina 1x10 30 L". Nga analiza e katalogut tuaj është konstatuar se keni ofruar "Qese për mbeturina 1x20x35 L", e cila nuk përputhet me specifikimet teknike të kërkuara.

2. Paramasa Nr. 19 - Lecka për pastrim të dritareve 1/1: Për pozicionin 19 është kërkuar "Lecka për pastrim të dritareve 1/1". Sipas katalogut të ofruar, ju keni ofruar produktin "German-style cloth" me sasi 10+2 copë, i cili nuk është sipas kërkesës 1/1 dhe nuk përputhet me specifikimet në paramasën e tenderit

3. Paramasa Nr. 24 - Lecka për pastrim pluhuri nga materiali mikrofiber (82% celuloza, 18% poliestër): Për pozicionin 24 është kërkuar "Lecka për pastrim pluhuri nga materiali mikrofiber 82% celuloza, 18% poliestër". Produkti i ofruar nga ju është "Spontex mikrofiber multi pack x4", i cili nuk përmban përbërësit e kërkuar dhe si i tillë është jashtë standardeve të përcaktuara në dokumentacionin e tenderit

4. Paramasa Nr. 34 - Dezinfektues për tavolina, karrige, tastatura, etj.: Sipas kërkesës për dezinfektues, produkti i kërkuar duhet të përmbante: aromë të mirë, 5% surfakantë jo jonike, limon, dezinfektues, alkalet, citratet dhe ngjyrë. Ju keni ofruar produktin "Asepsol disinfectant", i cili përmban përbërës të ndryshëm nga ata të kërkuar, duke përfshirë "quaternary ammonium compounds, benzalkonium chloride, isopropyl alcohol, disodium EDTA", dhe nuk është në përputhje me përbërjen e produktit sipas kërkesës në paramasë.

Përfundim: Në bazë të mospërputhjeve të konstatuara më sipër dhe duke respektuar në plotëni dispozitat e nenit 54 të Ligjit për Prokurimin Publik, dhe në bazë të këtyre argumenteve, pretendimi juaj nr. 3 konsiderohet i pabazuar. Lidhur me pretendimin nr. 4. Vendosja e çmimeve si 0,00€ në paramasë: Në paramasën e dorëzuar si pjesë e ofertës suaj, është konstatuar se keni vendosur çmime në vlerën 0,00% për disa artikuj. Kjo është në kundërshtim me kërkesat e tenderit, pasi artikujt duhet të kenë çmime reale për tu marrë në konsideratë për vlerësim financiar. Në përputhje me këtë analizë dhe bazuar në nenet përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik, oferta juaj eliminohet nga procedura e mëtejshme e vlerësimit. Sqarim për vendosjen e çmimeve në paramasë: Ju, si Operator Ekonomik (OE), keni theksuar se keni vendosur çmime reale për produktet, por që formula e përdorur nga AK ka llogaritur disa pozicione me çmimin 0.00. Nga shqyrtimi i detajuar i ofertës tuaj, është konstatuar se në disa pozicione të paramasës çmimet e vendosura për produktet rezultojnë të jenë 0.00 Ky është një gabim serioz në plotësimin e dokumentacionit tuaj të tenderit për disa arsye kryesore: 1. Ofertë e papërgjegjshme: Çmimet e vendosura me 0.00 në paramasë përbëjnë një mospërputhje të qartë me kërkesat e tenderit. Autoriteti Kontraktues ka vendosur qartë që për çdo pozicion duhet të vendoset një % përkatës për produktin e kërkuar. Vendosja e çmimit 0.00 % konsiderohet si ofertë e papërgjegjshme dhe në kundërshtim me standardet e tenderit. 2. Potencial për manipulim të çmimit: Vendosja e çmimeve 0.00 euro për pozicione specifike mund të interpretohet gjithashtu si një përpjekje për manipulimin e çmimit total të ofertës. Kjo praktikë, e cila rezulton në një llogaritje jo të saktë të vlerës së përgjithshme të ofertës, krijon një avantazh të padrejtë në raport me konkurruesit e tjerë që kanë respektuar kërkesat për vendosjen e çmimeve reale për secilin pozicion. 3. Kalkulimet e çmimeve: Nëse do të kishit vendosur çmime të sakta dhe të përputhshme me specifikimet për çdo pozicion të paramasës, atëherë oferta juaj do të reflektonte një total të saktë të përqindjeve. Sidoqoftë, për shkak të çmimeve 0.00 % të vendosura nga ana juaj, ky total është ndikuar nga këto gabime, gjë që e bën ofertën tuaj të papërgjegjshme për procedurën e tenderit dhe nuk është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, duke siguruar që të gjitha ofertat të jenë të barabarta, të drejta dhe në përputhje me kërkesat andaj pretendimi juaj nr. 4 konsiderohet i pabazuar. Në lidhje me pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankues mbi mosplotësimin e kërkesave të dosjes së tenderit nga ana e operatorit të rekomanduar për kontratë, komisioni vlerësues ka shqyrtuar me kujdes të gjitha dokumentet dhe mostrat e dorëzuara, dhe bazuar në vlerësimin e tyre, dëshirojmë të sqarojmë sa vijon: Përputhja e dokumentacionit dhe mostrave me kërkesat e tenderit: Operatori ekonomik i propozuar për kontratë ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin dhe mostrat e kërkuara në përputhje të plotë me specifikimet teknike dhe kërkesat administrative të dosjes së tenderit. Gjatë procesit të vlerësimit, komisioni ka konstatuar se mostrat e ofruara nga ky operator janë në përputhje me

specifikimet 8 teknike të përcaktuara në dokumentacionin e tenderit dhe plotësojnë të gjitha kriteret e nevojshme për produktet që janë kërkuar. Përgjegjshmëria administrative dhe teknike: Operatori ekonomik i propozuar për kontratë është vlerësuar si plotësisht përgjegjshëm administrativisht dhe teknikisht. Komisioni vlerësues ka siguruar që të gjitha dokumentet e dorëzuara nga operatori në fjalë janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, duke përfshirë përmbushjen e të gjitha kriterëve për përgatitjen e dokumentacionit dhe ofertën e tij teknike. Oferta me çmimin më të ulët: Operatori ekonomik i propozuar ka ofruar një çmim konkurrues, i cili është më i ulëti në krahasim me ofertuesit e tjerë që kanë qenë përgjegjshëm për kërkesat administrative dhe teknike të tenderit. Duke pasur parasysh që ky operator i plotëson të gjitha kërkesat dhe specifikimet, dhe ka ofertuar me çmim më të ulët, autoriteti kontraktues ka marrë vendimin për ta rekomanduar këtë operator për kontratë, në përputhje të plotë me parimet e ekonomisë dhe eficiencës në prokurim publik. Përputhshmëria me Ligjin për Prokurimin Publik: Vendimi për rekomandimin e këtij operatori është marrë në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe rregulloret në fuqi. Gjatë gjithë procesit të vlerësimit janë ndjekur procedurat e parashikuara nga ligji dhe janë respektuar të gjitha kriteret e vendosura në dosjen e tenderit. Përfundim: Pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankues nuk qëndrojnë, pasi operatori i rekomanduar për kontratë ka përmbushur plotësisht të gjitha kërkesat teknike dhe administrative. Oferta e tij është konsideruar e përgjegjshme dhe më e favorshme nga ana ekonomike, duke përmbushur kështu standardet e kërkuara për këtë aktivitet të prokurimit. Në përgjigje të pretendimeve tuaja të lartcekura lidhur me vendimin për dhënien e kontratës operatorit të propozuar, ju njoftojmë se autoriteti kontraktues ka vepruar në përputhje të plotë me dispozitat ligjore dhe specifikimet e dosjes së tenderit, duke respektuar të gjitha kriteret dhe procedurat e përcaktuara nga Ligji i Prokurimit Publik (LPP). Së pari, sa i përket pretendimeve për mosplotësimin e kërkesave nga ana e operatorit të rekomanduar për kontratë, pas ekzaminimit dhe vlerësimit të dokumentacionit dhe mostrave të dorëzuara, komisioni vlerësues ka konstatuar që operatori ekonomik ka dorëzuar të gjitha dokumentet dhe mostrat e kërkuara në përputhje të plotë me specifikimet teknike dhe kriteret e tenderit. Për më tepër, nuk janë evidentuar mospërputhje që do të ndikonin në përgjegjshmërinë e tij administrative apo teknike. Gjithashtu, në lidhje me vlerësimin e tenderit ekonomikisht më të favorshëm, bazuar në nenin 60 të LPP-së, operatori i rekomanduar ka ofruar një çmim konkurrues, i cili, duke marrë parasysh edhe plotësimin e kërkesave teknike, përmbush kriteret e dhënies së kontratës. Ndërsa, pretendimet tuaja për diskriminim janë të pabazuara, pasi autoriteti kontraktues ka trajtuar të gjithë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe transparente, në përputhje me nenin 7 të LPP-së. Në përputhje me nenin 59 të LPP-së, është bërë vlerësimi i plotë dhe i drejtë i të gjitha ofertave të dorëzuara, dhe operatori i rekomanduar ka rezultuar më i favorshëm, jo vetëm për çmimin, por edhe për përputhshmërinë e plotë me kriteret dhe specifikimet teknike. Autoriteti kontraktues ka marrë vendimin duke respektuar të gjitha dispozitat ligjore të LPP-së dhe nuk ka pasur asnjë favoritizim ndaj ndonjë operatori ekonomik. 9 Në përfundim, vendimi i autoritetit kontraktues për dhënien e kontratës është bazuar në një proces të drejtë dhe transparent, duke përmbushur të gjitha dispozitat ligjore të aplikueshme dhe duke garantuar shfrytëzimin efikas të fondeve publike. Si rezultat, kërkesa juaj për rishikim është e pabazuar dhe nuk sjell fakte që do të ndryshonin rezultatin përfundimtar.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 14.10.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2024/0906, ndërsa me datë 25.10.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues dhe teknik me nr. 2024/0906 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar lidhur me rekomandimin e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me mendimin e ekspertit.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 08.10.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0940/2024

Lidhur me ankest nr. 0940/24 me datën 14.11.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet tërësi aktiviteti i prokurimit, dhe nëse AK edhe më tutje ka interes për zhvillimin e këtij aktiviteti të prokurimit, lëndën ta ritenderoj në pajtim me dispozitat e LPP.

Raportin e ekspertizës me nr.0940/24 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, si dhe OE pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit shqyrtues, parashtrësit dhe dokumentet e ankuesve, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e N.T.SH. GIPA., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0906 ka vlerësuar si në vijim:

Lidhur me pretendimin e OE-ankues për arsyen eliminimit nga AK për kodin e mostrave:

Eksperti shqyrtues gjatë vlerësimit të ofertës së operatorit ekonomik ankues, të dokumenti “ formulari i tenderit ” mund të shihet se operatori ekonomik e ka paraqitur kodin e mostrave në

formualrin e tenderit.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik për arsyen e eliminimit nga AK për mosdorëzimin e deklaratës se OE duhet të ofrojë deklaratën se të gjitha materialet duhet të jenë ekologjike, në ofertën e OE- ankues, është ofruar deklarata sipas kërkesës së AK.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Rahovecit në njëren prej arsyeve të eliminimit e ka eliminuar operatorin ekonomik ankues me arsyen se nuk e keni ofruar kodin e mostrave (si kusht administrativ) derisa ka vazhduar duke bërë vlerësimin e specifikave të mostrave.

Përfundim:

Autortieti Kontraktues Komuna e Rahovecit nuk ka bërë vlerësimin e ofertës të operatorit ekonomik ankues në pajtim me rregulloren për prokurim publik, 001-2022 përkatësisht neni: 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahassimi i Tenderëve, duke e refuzuar ofertën e operatorit ekonomik ankues edhe përkunder se OE-ankues i ka ofruar dëshmitë.

Eksperti Shqyrtues Rekomandon të bëhet anulimi i njoftimit për dhënje të kontratës të Autoriteti Kontraktues Komuna e Rahovecit, procedura të kthehet në rivlerësim dhe gjatë rivlerësimit Autoriteti Kontraktues Komuna e Rahovecit, të bëjë vlerësimin e ofertës së operatorit ekonomik ankues në pajtim me nenin 40 të RRPP, dhe oferta e OE-ankues te trajtohet në pajtim me nenin 4 të rregullores për prokurim publik si në vijim:

Neni 4 Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit

4.1 Gjatë administrimit të procedurave të prokurimit, Autoriteti Kontraktues do të ketë obligimet në vijim: a. të luaj rolin aktiv në përcaktimin e kushteve të kontratave, me theks të veçantë për çmimet, afatet e dorëzimit, sasitë, karakteristikat teknike dhe garancive b. për aq sa është e mundshme në bazë të rrethanave, të bëhet krahasimi efektiv i kërkesave për pjesëmarrje dhe tenderëve për të përcaktuar avantazhet e tyre relative dhe disavantazhet; dhe c. të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut.

Lidhur me pretendimet e OE “Shaip Mustafa” B.I., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0940 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimi nr.1; Pretendimi i parë ankimorë sipas ankesës nr.109/24 ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE ankues, ku sipas AK-së i njëjti në formular për dorëzim të tenderit nuk ka vendosur kodin e mostrave në pajtim me nenin 37 të rregullorës për prokurim publik.

OE pretendon se ka dorëzuar mostrat dhe në ato mostra është vendosur kodi nga OE.

Rregullorës për prokurim publik 001 – 2022:

Neni 37 Mostrat e Tenderëve

37.1 Dokumentet e tenderit në përgjithësi duhet të shmangin kërkesën për paraqitjen e mostrave, pasi kjo kërkesë dekurajon konkurrencën dhe rrit çmimet e ofertës. Përndryshe, tenderuesve duhet tu kërkohej të konfirmojnë që produkti i tyre plotëson specifikimet e kërkuara dhe në mbështetje të bashkëngjitni çertifikatat e duhura të testimit nga laboratorë të njohur testimi.

37.2 Kur kërkohej mostrat ato mund të dorëzohen paraprakisht, ose gjatë kohës së mbylljes së tenderit. Ato duhet të dorëzohen para afatit të fundit për dorëzim të tenderëve.

37.3 Mostrat e dorëzuara nga OE si kusht duhet të inspektohen nga një komision.

37.4 Në mënyrë që të parandalohen mundësitë e njëanshmërisë së përzgjedhjes, para procesit të vlerësimit, mostrave të dorëzuara duhet t'i:

a. eliminohen të gjitha shenjat të cilat mund të identifikojnë OE; dhe

b. shënohen nga një kod.

37.5 Personi që eliminon shenjat nga mostrat dhe që vendos kodet nuk do të merr pjesë në procesin e vlerësimit dhe nuk do të bëjë të ditur identifikimin e mostrave për anëtarët e komisionit të vlerësimit.

Sipas dispozitave të cekura më lart, është përgjegjësi e AK-së që të eliminohet qfardo shenje që identifikon OE, dhe personi që eliminon shenjat dhe vendos kodet nuk merr pjesë në vlerësim dhe nuk e bënë të ditur identifikimin e mostrave.

Përveq kësaj AK në arsyet të dytë të eliminimit pohon se mostrat e dorëzuara nuk janë në pajtim me kërkesat e dosjes, qka nënkupton se AK e ka ditur se OE ka dorëzuar mostra dhe e ka ditur cila mostër është mostra e OE ankues në këtë rast.

Bazuar në këto që u cekën më lart, fakti që OE ankues nuk ka shënuar në formular për dorëzim fjalën “mostrat” është devijim i vogël i cili nuk përbën ndryshim material apo shmangje nga përgjegjësitë e OE dhe nuk e kufizon AK-në në asnjë mënyrë përderisa AK ka pranuar dhe ka identifikuar mostrat e OE ankues.

Pretendimi nr.2 ; Arsyeja tjetër e eliminimit nga AK është se mostrat e ofruara nga OE ankues nuk janë në pajtim me kërkesat e dosjes, mirëpo (ashtu siq pretendon OE ankues) AK nuk ka dhënë asnjë arsyetim apo sqarim konkret se cila mostër cilat kërkesa të dosjes nuk i plotëson.

Bazuar në këtë që u cek më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar.

Pretendimi nr.3 ; Arsyetimi tjetër për eliminim të OE ankues, sipas AK0së është se nga katalogjet e ofruar ashihet se produktet e ofruara nuk janë në pajtim me kërkesat e dosejs.

Pas analizimit të pretendimeve ankimore dhe dosjes së tenderit – specifikimit teknik, vlerësojmë se për pozicionet/ produktet : lecka për pastrimin e dritareve dhe pozicioni lecka mikrofibrë, AK nuk ka dëshmuar se produktet e ofruara nuk janë në pajtim me kërkesat e dosjes.

Sa i përket pozicionit për dezinfektues ku AK pretendons e : përmban përbërës të ndryshëm nga ata të kërkuar, duke përfshirë "quaternary ammonium compounds, benzalkonium chloride, isopropyl alcohol, disodium EDTA”...

Sqarojmë se specifikacioni teknik për dezinfektues në dosje të qenë :“Dezinfektues te tavolinave,karrikave ,tastaturave etj .Duhet te permbaje arome te mire dhe duhet te permbaje 5% surfakante jo jonike ,arome,limon,dezinfektues ,alkalet ,citratat dhe ngjyre”.

Bazuar në këtë kërkesë, përbërësit kimik te dezinfektuesit të OE ankues hyjnë në grupin e “dezinfektues, surfakantë, alkalet”, andaj konsiderojmë se pretendimi ankimor është i bazuar.

Fakti që nuk të shënim për aromë limoni mendojmë se mund të konsiderohet devijim i vogël, pasi edhe oferta e OE të rekomanduar për kontratë ka devijime të qeset dhe shportat dhe fshesat, siq janë prezantuar nga OE ankues.

Situatë e ngjashme është edhe për Qese për mbeturina 1x10 30 L, ku OE ankues ka ofruar qese 1x20 35l.

Do thotë është kërkuar qese 30 litërshe me pako nga 10 copë, ndërsa është ofruar qese 35 litra me pako 20 copë.

Në këto rrethana AK do duhej të trajtoj OE-të në mënyrë të barabartë, në kuptim që ose duhet të trajtohen të dy ofertat me devijime të vogla, ose të dyja duhet të eliminohen.

Pretendimi nr.4 ; Arsyeja e fundit e eliminimit sipas AK është se për disa pozicione OE ankues ka ofruar çmime zero.

Pas analizimit të ofertës së OE ankues dhe dosjes së tenderit, fillimisht sqarojmë se sipas dosjes çmimet me më shumë se dy numra pas presjes nuk do të merren parasysh.

Ndërsa OE nuk ka ofruar çmime për njësi zero, i njëjti gjatë peshimit është detyruar të shkruaj çmime 0.00€, pasi çmimi i dhënë psh 0.35€ ku peshohet me 0.5% (peshë e vendosur nga AK) jep vlerën 0.005, andaj në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit OE nuk ka shënuar më shumë se dy numra pas presjes dhjetore.

AK e kufizon numrin e shifrave pas presjes dhjetore derisa është derisa ka aplikuar peshim të çmimeve ka krijuar rrethana qe bëjnë të pamundur vlerësimin e barabartë në mes të OE-ve, pasi si në rastin konkret edhe pse OE ka dhënë çmim 0.35€, sipas formulës dhe kushteve të dosjes sw tenderit detyrohet qe te peshimi të vendos çmimin 0.00.

Përveç kësaj, për këtë natyrë të këtij furnizimi (material higjieniko sanitar për shkolla), nuk është natyrë e furnizim për të cilat AK nuk mund të dij sasi të përafërta dhe nuk arsyeton zhvillimin e procedurës duke vendosur sasi 1 për të gjitha pozicionet.

Në rast të ri tenderimit, i rekomandojmë që AK të aplikoj kontratë kornizë me sasi të indikative, nga të cilat lejohet devijimi plus/minus 30%.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues sipas ankeses nr 2024/0906, dhe ankesa me nr 2024/0940, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin shqyrtues.

Lidhur me ankesën nr : 2024/0906, te OE ‘GIPA’, Panelin gjate seances degjimore te mbajtur me daten 06.12.2024 , ka kërkuar nga ekspertit shqyrtues ti egzaminon mostrat pran AK-se , ku PSH eshte paisur me me raport plotesues. Mirpo pas analizimit te ankeses me nr :2024/0940 ka analizuar proceduren në tërësi dhe se nga te gjeturat ka konstatuar qe procedura prokurorese e inicua nga AK-ja Komuna e Rahovecit nuk është inicuar sipas dispozitave të LPP-së.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se AK -ja ka inicuar procedure kontrat publike kornize për 12 muaj kalendarik , dhe pas analizimit në tërësi të reporteve te ekspertizave me nr. 2024/0906, te OE GIPA, dhe OE “Shaip Mustafa” B.I., me nr. 2024/0940, dhe te gjeturave gjate administrimit vuri ne pah se Ak-ja nuk ka respektuar dispozitat ligjore , në dosje të tenderit tek Aneksi 1 ka të pershkruara citat : “SPECIFIKAT TEKNIKE JANE TE BASHKANGJITURA/PERSHKRUARA NE PERSHKRIMIN E ÇMIMEVE Sasia e parashikuar është vetëm sasi Indikative. Devijimi i lejuar nga sasia totale indikative është: +-30%” , ndersa tek tek Lista e cmimeve në pozicione ka vendosur perqindje (procedur prokurorese sipas poentimit pa percaktuar sasi indikative) , poashtu është vrejtur që peshimi (poentomi në %) nuk është bërë sipas dispozitave ligjore ku sipas Listes se çmimeve si ne vijim: Artikulli nr. 1 pershkrimi me peshim të caktuar : 1.0 %; Art 2 : 2.0 %; Art 3; 1.0%; Art 4; 1.0%; Art 5 ; 2.0 %; Art:6 ; 2.0 %; Art 7 : 1.0% dhe Art 8; 2.0 % e qe perqindja ne total i bije te jete 12 % , e qe në realitet perqindjet e percaktuara duhet ta arin 100 % -shin e jo siç ka vepruar AK-ja . Poashtu tek artikulli me pershkrim; Detergjent pastrimi kunder mykut 700ml cope nuk ka te vendosur fare sasi. Këto kontradita sikurse ne Aneksin 1 te DT-së , ku ka paraqitur devijimin e lejuar nga sasia totale indikative, me listen e çmimeve për sasi 01 jane kontradiktive njëra me tjetrën. AK-ja ka perdorur procedure e prokurimit për këtë aktivitet në kundërshtim më neni 38 të LPP-së dhe, Rregulloren per Prokurim Publik 001/2022 , ku nenit 54 i RRPP-se çartësishte e përshkruar se kur mund te perdoret një procedur me sasi 01 sipas poentimit (peshimit) . Ne rastin konkret AK-ja duhet ta percakton sasin indikative ku mund ta ofron devijimin e lejuar (tarvanin) prej +- 30 % te sasisë. Dhe ne raste se AK-ja do ta nenshkronte kontraten sipas kësaj procedure që ka inicuar , atëher nje kontrat e tille do te ishte jo-efektive sepse ne artikuj ka percaktuar ne disa artikuj me 1, e në njëren nga artikujt pa asnje sasi , si dhe përqindjet me: 1.0 % e 2.0 % e qe ne total i del te jete 12 % e jo 100 % siq kerkohet.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve

ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesat e Operatorit Ekonomik N.T.SH. GIPA me nr. 2024/0906, si dhe OE “Shaip Mustafa” B.I., me nr. 2024/0940 ti aprovohon si pjesërisht e bazuar.

Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “FURNIZIMI ME MATERIAL HIGJENIKO – SANITAR PËR SHKOLLAT E KOMUNËS SË RAHOVECIT” me nr. të prokurimit: 623-24-8150-1-2-1, të anulohet B58Njoftimi për dhënie të kontratës, dhe aktiviteti i prokurimit duhet të anulohet në tersi sipas arsyesimit në vendim, dhe nëse AK edhe më tutje ka interes për zhvillimin e këtij aktiviteti të prokurimit, lëndën ta ritenderoj në pajtim me dispozitat e LPP .

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetin i prokurimit të anulohet në tersi, dhe nëse AK edhe më tutje ka interes për zhvillimin e këtij aktiviteti të prokurimit, lëndën ta ritenderoj në pajtim me dispozitat e LPP.

Paneli shqyrtues i shqipton vrejtje AK-se lidhur me procedurat kur kerkohen- dorezohen mostrat ku neni 37 i RRPP-së e përcakton çartë se si duhet të pranohen mostrat gjate dorzimit nga një OE kur ato kerkohen nga AK-ja në një aktivitet të prokurimit .

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues konkretisht ZPP-ja që të jetë i vëmendshëm gjatë inicimit të procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veprojnë në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Në të kundërtën OSHP mund të iniciojë procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale-Departamenti Administratë në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË**
- **OE - N.T.SH. GIPA**
- Arkivës së OSHP-së: